Kronikë

# Vlorë/ Eksploziv lokalit në pronësi të familjes së Bledar Birçajt, i vrarë në 2021! 'The boss' sapo ishte rihapur, dëme materiale! Autori me maskë shpërtheu tritolin me fitil

*Shpërthimi ka ndodhur rreth orës 06:00 të mëngjesit të sotëm tek 'Uji i Ftohtë'. Lokali, i cili funksiononte si bar, restorant e piceri, në Lungomare ishte në pronësi të familjes së Bledar Birçajt i cili* ***u ekzekutua*** *me breshëri plumbash në 10 maj të vitit 2021 në makinën e tij në lagjen 'Hajro Çakërri'.* ***Pista kryesore e hetimit: Hakmarrja***

- Sot i vunë tritol lokalit në Vlorë, 3 vjet më parë pronari i 'The Boss' u ekzekutua me kallashnikov në makinë! Autorët e pritën në kthesë
- Detajet/ Pista e hetimit: Hakmarrja
- Kamerat filmuan autorin, pasi ndezi fitilin u largua mes pallateve
- VIDEO/ Dëmet e shkaktuara nga eksplozivi

Redaksia
8 Dhjetor, 07:15 | **Përditesimi: 8 Dhjetor, 10:54**

Share

**Vlore-** Një sasi tritoli shpërtheu mëngjesin e sotëm (8 dhjetor 2024) në ambientet e jashtme të lokalit 'The Boss' që ndodhet në shëtitoren buzë detit në Vlorë. Shpërthimi ndodhi rreth orës 06:00 e deri tani raportohet vetëm për dëme materiale.

Lokali, funksiononte si bar, restorant e piceri, në Lungomare ishte në pronësi të familjes sw Bledar Birçajt i cili **u ekzekutua** me breshëri plumbash në 10 maj të vitit 2021 në makinën e tij në lagjen 'Hajro Çakërri'.

'The Boss' nuk kishte funksionuar prej kohësh por kishte vetëm pak ditë që ishte rihapur, informon gazetari i Report Tv dhe shqiptarja.com Armand Xhelili. Lokali ishte në pronësi të nënës, Resmie Birçajt. ka qënë me qira, por ishte marrë sërish nga pronarët, vëllezërit e Bledarit të cilët kanë pak kohë që e kanë vënë në punë.

Report tv dhe shqiptarja.com sjell pamjet e para nga dëmet e shkaktuara ndërsa forcat e policisë ndodhen në vendngjarje për të mbledhur provat. Pjesa ballore e lokalit e cila rezulton të ketë qenë me xham është thyer dhe dëmtuar.

LEXO EDHE:
**Vlorë, vodhën banesën e marrë me qira nga dy shtetase të huaja, kamerat e sigurisë zbulojnë hajdutët! Njëri prej 3 të arrestuarve, i dënuar për vrasje në Greqi (EMRAT+VIDEO)**

Kamerat e lokalit kanë filmuar autorin i cili ka qenë me maskë. Ai ka ardhur nga ana e lokaleve dhe pasi ka vendosur tritolin me fitil e ka ndezur duke shkaktuar shpërthimin. Më pas është larguar mes pallateve. Gazetari Xhelili informon se edhe kamerat përreth kanë filmuar lëvizjet e autorit.

> *Rreth orës 06:00, në lagjen "Uji i Ftohtë", në një lokal, në pronësi të shtetases R. B., ka shpërthyer, dyshohet lënde plasëse, ku si pasojë janë shkaktuar vetëm dëme materiale. Grupi hetimor vijon veprimet për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve, njoftoi policia*

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com




Lajmi në përditësim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:47

## Shpërthimi tek lokali 'The Boss' në Vlorë, kamerat fiksuan autorin me kapuç të zi, pasi ndezi fitilin u largua me biçikletë

Detaje të reja lidhur me shpërthimin para lokalit 'The Boss' në zonën e Ujit të Ftohtë në Vlorë. Kamerat e sigurisë kanë fiksuar autorin me kapuc të zi I cili ka dalë nga pallatet dhe është afruar tek lokali. Më pas ka vendosur tritolin me fitil.

Pasi e ka ndezur ka marrë biçikletën dhe është larguar sërish mes pallateve. Këto lëvizje janë fokusuar në kamerat e sigurisë. Ende nuk ka të shoqëruar.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:16

## Sot i vunë tritol lokalit në Vlorë, 3 vjet më parë pronari i 'The Boss' u ekzekutua me kallashnikov në makinë! Autorët e pritën në kthesë

Bledar Birçaj u ekzekutua me kallashnikov teksa lëvizte me mjetin e tij tip BMË në zonën e quajtur Bishti i Kalldrëmit në Vlorë. Atentati ndodhi rreth orës 13:00 në 10 maj 2021.

40 vjeçari ishte në makinë me Granit Deromemaj, në atë kohë efektiv i Antidrogës, por që më pas u përjashtua nga Policia e Shtetit.

Kamerat e sigurisë së një karburanti afër vendit ku ndodhi ngjarja regjistruan të gjithë skenën.

Sapo mjeti BMË ka mbërritur pranë karburantit, dalin nga makina 2 persona, të maskuar e të armatosur duke qëlluar me breshëri në drejtim të shoferit dhe më pas nxitojnë të largohen nga vendi i ngjarjes. Në tentativë e sipër duke u larguar, një prej autorëve i bie arma nga duart dhe kthehet për ta marrë pas shumë pak sekondash.

Në drejtim të automjetit u qëllua mbi 30 herë.

Pasi ekzekutorët u larguan, Granit Deromemaj del nga makina dhe largohet me vrap, ndërkohë Birçaj dërgohet në spital ku dhe humbi jetën.

Vrasja e Bledar Birçaj ka mbetur ende pa autor, ndërsa pista kryesore e hetimit atëherë u tha se ishin konfliktet e mundshme të tij në Spnjë, prej nga ishte kthyer një muaj para se të ekzekutohej.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:00

## VIDEO/ Shpërthimi tek 'The Boss' në Vlorë, Njësia antieksploziv tek lokali për të mbledhur provat

Njësia antieksploziv ndodhet në lokalin ‘The Boss’ ku ndodhi shpërthimi për të mbledhur provat materiale si dhe për të përcaktuar llojin dhe sasinë e lëndës plaëse që është përdorur.

Kamerat e sigurisë kanë filmuar një person me maskë që I afrohet lokalit, vendos tritolin me fitil dhe më pas e ndez për të ndodhur shpërthimi 5 sekonda më pas.

Autori më pas është larguar mes pallateve. Kamerat e sigurisë edhe të bizneseve përreth kanë filmuar lëvizjet e autorit.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 08:42

## Detaje nga shpërthimi në Vlorë/ Tritoli në lokalin në pronësi të familjes së Bledar Birçajt, i vrarë në 2021! Dyshohet hakmarrje

(Foto: Bledar Birçaj, i vrarë në 2021

Detaje të reja nga shpërthimi me tritol në lokalin 'The Bosss' tek Uji i Ftohtë në Vlorë. Ngjarja dyshohet të ketë ndodhur për hakmarrje, pasi bar restoranti “ The boss” ku u vendos sasia tritolit ka qënë në pronësi të **Bledar Birçaj i cili u ekzekutua** me breshëri plumbash në 10 maj të vitit 2021 në makinën e tij në lagjen ‘Hajro Çakërri’.

Lokali ka qënë me qera, dhe është marrë sërish nga pronarët (vëllezërit e Bledarit) të cilët kanë pak kohë që e kanë vënë në punë.

Lokali është në emër të nënës Resmie Birçaj.

VIDEO- Vrasja e Bledar Bircajt ne 2021

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 08:02

## Shpërthimi në lokalin tek 'Uji i Ftohtë' në Vlorë Kamerat filmuan autorin, pasi ndezi fitilin u largua mes pallateve

Kamerat kanë filmuar një person me maskë që ka vendosur sasinë e tritolit në ambientet e jashtme të lokalit. Ndërkohë policia ka shpërndarë një njoftim zyrtar ku thuhet se lokali '[The Boss](#)' ka qenë në pronësi të një gruaje.

> *Rreth orës 06:00, në lagjen "Uji i Ftohtë", në një lokal, në pronësi të shtetases R. B., ka shpërthyer, dyshohet lënde plasëse, ku si pasojë janë shkaktuar vetëm dëme materiale. Grupi hetimor vijon veprimet për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve.*

S.G/Shqiptarja.com

Share

S.G/r.k./Shqiptarja.com

**TAG:** resmie bircaj | bledar bircaj | the boss | shperthim me tritol | shperthim | Vlore

Komento

## Komente

**Shaban:** 08/12/2024 08:49

Hetoni resmien se me pension e ka blere lokalin?????

**Përgjigju**

**Soni:** 08/12/2024 12:21

O komentus mun te kete bere shume faje po i mori me vete po me nenen dhe familjen mos te meren se nuk e kane fain prindrit tulla dhe llaci e ka fain shteti dhe policia e vlores qe eshte me e kruptuara ne bote se i dine kush e vrau dhe kush i bene po nuk duan sic nuk duan per gjarjet e tjera per ti zbardhe se marin leket te gjitha i dine vrasjet e te tjera vetem ligji me vdekje i ndalon pse nuk bejne ne dubai trimat po ka cecua bicak jane shoke te gjithe

**Turi:** 08/12/2024 10:26

Po flasim per ata qe e kane vendosur tritolin dhe per vrasesit e atij djalit kurse ti ke hallin se si e kane blere lokalin , te grin nga brenda se nuk ke ber ndonje gje ne jete apo jo

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH COM

**Sondazhi i ditës:**

7 Dhjetor, 15:58

**Sipas jush kush duhet ta numërojë votën e diasporës?**

KQZ | Partitë | Nuk e di

## Lajme të tjera

**Priten reshje me intensitet të lartë në Vlorë, Bashkia apel qytetarëve: Bëni kujdes! Rrugët ku s'duhet të parkoni automjetet**

8 Dhjetor, 07:42

**Shpërthim i fuqishëm në një bllok banesash në Hagë, raportohet për 20 viktima! Vijojnë kërkimet në rrënoja (VIDEO)**

7 Dhjetor, 12:30

**Konispoli prodhon 50 mijë ton mandarina, prek tregjet më të mëdha nga Polonia deri në Rusi**

Limos Didani

7 Dhjetor, 10:49

**Vlorë/ Vodhën një shtëpinë e dy të huajave, në kërkim 2 autorët**

7 Dhjetor, 10:26

**Kufizimi i përdorimit të TikTok, kryeministri Rama: 394 takime, mbi 14 mijë prindër pjesëmarrës! Po kontribuojnë me ide dhe sugjerime (FOTO)**

6 Dhjetor, 17:14

**Eduard Zaloshnja: 48.1% e shtetasve shqiptarë nuk banojnë në Shqipëri**

Eduard Zaloshnja

6 Dhjetor, 15:48

Sarandë/ Goditën me sende te forta 19 vjeçarin, 3 të rinj në kërkim

5 Dhjetor, 10:07

VanHorn në Vlorë: Reforma në drejtësi është punë e të gjithëve, nuk është vetëm SPAK

4 Dhjetor, 13:49

Rrjedh bombola e gazit, shkrumbohet dyqani në Vlorë

4 Dhjetor, 13:29

Do ekzekutonte të 'fortin' e Vlorës dhe shokun e tij për hakmarrje, SPAK çon për gjykim Amarildo Nikollin! Si i dështoi atentati, u kap me pistoletë gati për qitje

Keti Banushi

4 Dhjetor, 09:37

Media amerikane 'Travel off Path': Vlora, qyteti bregdetar i mbushur me brigje mahnitëse dhe vendpushime të qeta

4 Dhjetor, 08:29

VIDEOLAJM/ Peshkaqeni i rrallë zbulohet në Orikum, bie në rrjetën e peshkatarëve

2 Dhjetor, 13:14



© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje